

L I G J
Nr.8533, datë 14.10.1999

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM
(IDA) PËR PROJEKTIN E DYTË TË REHABILITIMIT TË UJITJES DHE KULLIMIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë së zhvillimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e dytë të rehabilitimit të ujitjes dhe kullimit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.2460, datë 18.10.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

Numri i Kredisë 3232 AL

MARRËVESHJA E KREDISË SË ZHVILLIMIT

- Projekti i Dytë i Rehabilitimit të Ujitjes dhe Kullimit ndërmjet Shqipërisë
dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar (IDA) -

MARRËVESHJA, e datë 18 korrik, 1999, ndërmjet SHQIPËRISË (Huamarrësi) dhe SHOQATËS PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (Shoqata).

MEQENËSE: (A) Huamarrësi, i bindur përsa i përket fazës përgatitore dhe prioritetit të Projektit të përshkruar në Kreun 2 të kësaj Marrëveshjeje, ka kërkuar financimin e Projektit nga Shoqata;

(B) MEQENËSE Shoqata ka rënë dakord në parim, ndërmjet të tjerash, për sa më sipër, të shtyjë afatin e Kredisë së Huamarrësit sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje;

QË KËTEJ E TUTJE të dyja palët bien dakord si më poshtë:

Neni I

Kushtet e Përgjithshme; Përkufizime

Seksioni 1.01 “Kushtet e Përgjithshme të Zbatueshme për Marrëveshjet e Kredive të Zhvillimit” të Shoqatës, i datës 1 janar 1985, i ndryshuar në 2 dhjetor 1997, me modifikimet e përcaktuara më poshtë (Kushtet e Përgjithshme) janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje:

(a) Një paragraf i ri (12) i është shtuar Seksionit 2.01 i shënuar më poshtë, dhe paragrafet ekzistuese (12) deri në (14) të këtij Seksioni janë shënuar përkatësisht si paragrafet (13) deri në (15):

12. “Vend Pjesëmarrës” nënkupton çdo vend për të cilin Shoqata vendos të plotësojë kërkesat e përcaktuara në Seksionin 10 të Rezolutës nr.183 të Bordit të Guvernatorëve të Shoqatës, i adoptuar më 26 qershor 1996; dhe “Vende Pjesëmarrëse” nënkupton të tilla vende bashkarisht.

(b) Fjala e dytë e Seksionit 5.01 është modifikuar si më poshtë:

“Përveç rasteve kur Shoqata dhe Huamarrësi bien dakord, nuk do të bëhet asnjë tërheqje fondesh: (a) për shpenzime në territoret e çdo vendi që nuk është vend pjesëmarrës ose për mallra të prokuruar në, ose shërbime të ardhura nga territore të tilla; ose (b) për qëllime pagese ndaj personave apo njësive, ose për importim mallrash, nëse një pagesë apo importim i tillë, sipas njohurive të Administratorit, ndalohet nga vendimi i Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, përcaktuar në Kreun VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Seksioni 1.02. Nëse nuk kërkohet ndryshe, disa terma të përmendura në Kushtet e Përgjithshme dhe në Hyrjen e kësaj Marrëveshjeje kanë kuptimet përkatëse të përcaktuara aty dhe termat e mëposhtme të shtuara kanë kuptimet e mëposhtme:

(a) “Përfituesi” ose “Përfituesit” nënkuptojnë FSHPU-të dhe/ose SHPU-të që do të marrin pjesë në zbatimin e skemave në Pjesën A të Projektit;

(b) “KESH” nënkupton Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare, një kompani e krijuar në vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave të Huamarrësit nr.34, datë 12 gusht 1993.

(c) “Ligji nr.7846” nënkupton se ligji mbi Administrimin e Ndërtimeve, Mirëmbajtjen dhe Shfrytëzimin e Veprave të Ujitjes dhe Kullimit të Huamarrësit i datës 21 korrik 1994 është ndryshuar sipas datës së kësaj Marrëveshjeje;

(d) “MBU” nënkupton Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit të Huamarrësit;

(e) “PMU” nënkupton Njësinë e Zbatimit të Projektit për zbatimin e projektit të dytë të rehabilitimit të ujitjes dhe kullimit i krijuar në rregulloren e MBU-së, datë 5 prill 1999;

(f) “Udhëzimet Operative” nënkuptojnë udhëzimet që përmbajnë kriteret administrative, financiare, promovimet, vlerësimet dhe supervizionin që do të ndiqen nga PMU dhe do të aprovohen në vijim të paragrafeve të Seksionit 6.01 (b) të kësaj Marrëveshjeje;

(g) “Trojet Ramsar” nënkuptojnë trojet e caktuara nga Huamarrësi nën Konventën e Tokave të Lagështa të Rëndësisë Ndërkombëtare, veçanërisht si Vendqëndrim i Shpendëve të Ujit, Ramsar, Iran, 2 shkurt 1971, ndryshuar nga Protokolli i Parisit më 12 mars 1982;

(h) “Llogaria e Veçantë” nënkupton llogarinë e përmendur në Seksionin 2.02 (b) të kësaj Marrëveshjeje;

(i) “Shoqata Sipërmarrëse” nënkupton një komitet të menaxhimit të mjedisit me bazë komuniteti, që përfshin përfaqësues nga fermerë (SHPU), peshkatarë, bashkitë, qeveritarë (Agjencia Kombëtare e Mjedisit të Huamarrësit dhe MBU) dhe përfaqësues të komuniteteve vendore;

(j) “Skemë” nënkupton një projekt të veçantë zhvillimi për t’u kryer nga PMU dhe Beneficieri duke përdorur pjesë fondesh nga Kredia nën Pjesën A të Projektit; dhe

(k) “DU” nënkuptojnë Drejtoritë e Ujrave, direktoratet e ujrave në rrethe të MBU-së dhe

(l) “SHPU” dhe “FSHPU” nënkuptojnë Shoqatat e Përdoruesve të Ujit dhe Federatat e SHPU-ve të ngritura në bazë të ligjit nr.7846.

Neni II

Kredia

Seksioni 2.01. Shoqata bie dakord t’i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose të referuara në Marrëveshjen e Kredisë së Zhvillimit, një shumë në valuta të ndryshme të barasvlefshme me shtatëmbëdhjetë milionë e shtatëqind mijë Të Drejta të Veçanta të Tërheqjes (SDR, 17,700,000).

Seksioni 2.02 (a) Shuma e Kredisë mund të tërhiqet nga Llogaria e Kredisë në përputhje me vendimet e Kreut 1 të kësaj Marrëveshjeje për shpenzimet e bëra (ose, nëse Shoqata do të bjerë dakord, për shpenzimet që do të bëhen) në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve që kërkohen për Projektin dhe që do të financohen nga fondet e Kredisë.

(b) Huamarrësi, për qëllime të Projektit, mund të hapë dhe të mirëmbajë në dollarë një llogari të veçantë depozituese në Bankën e Shqipërisë sipas termave dhe kushteve të përcaktuara nga Shoqata. Depozitimet në, dhe pagesat nga Llogaria e Veçantë do të bëhen në përputhje me vendimet e Kreut 5 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 2.03. Data e Përfundimit do të jetë 31 mars 2005, ose një datë e mëvonshme e përcaktuar nga Shoqata. Shoqata do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Seksioni 2.04 (a) Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një tarifë mbi shumën e Kredisë që nuk mund të tërhiqet herë pas here përveçse më 30 qershor të çdo viti siç përcaktohet nga Shoqata, por që nuk duhet të kalojë gjysmën e 1 përqindëshit për vit (1/2 e 1%).

(b) Tarifa do të rritet: (i) nga data 60 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje (data e rritjes) deri në datat përkatëse në të cilat shumat do të tërhiqen nga Huamarrësi nga Llogaria e Kredisë ose do të anulohen; dhe (ii) në një përqindje të vendosur në 30 qershor që menjëherë paraprin datën e rritjes ose në përqindje të tjera që mund të përcaktohen herë pas here në vijim të paragrafit (a) më lart. Përqindja e vendosur në 30 qershor në çdo vit do të aplikohet nga data e pagesës tjetër, në atë vit të përcaktuar në Seksionin 2.06 të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Tarifa do të paguhet: (i) në vendet që do të kërkojë Shoqata; (ii) pa asnjë lloj kufizimi të imponuar nga, ose në territorin e Huamarrësit; dhe (iii) në valutën e përcaktuar në këtë Marrëveshje për qëllimet e Seksionit 4.02 të Kushteve të Përgjithshme ose në një valutë ose valuta të tjera të përshtatshme, që herë pas here mund të përcaktohen ose përzgjidhen në vijim të vendimeve të këtij Seksioni.

Seksioni 2.05. Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një tarifë shërbimi sipas koeficientit tre të katërtat e një përqindëshit (3/4 e 1%) në vit mbi shumën e Kredisë së tërhequr herë pas here.

Seksioni 2.06. Tarifat dhe tarifat e shërbimeve do të paguhen çdo gjashtë muaj në 15 janar dhe 15 korrik në çdo vit.

Seksioni 2.07 (a) Subjekt i paragrafeve (b) dhe (c) më poshtë, Huamarrësi do të ripaguajë shumën e Kredisë me këste gjashtë mujore të pagueshme në çdo 15 janar dhe 15 korrik, duke filluar në 15 korrik 2009 dhe mbaruar në 15 janar 2039. Çdo këst, duke përfshirë dhe këstin e paguar në 15 janar 2019 do të jenë një përqind (1%) e kësaj shume, dhe çdo këst pas kësaj do të jetë dy përqind (2%) e kësaj shume.

(b) Kur: (i) prodhimi i përgjithshëm kombëtar (GNP) i Huamarrësit, siç përcaktohet nga Shoqata, do të ketë tejkaluar për tre (3) vite të njëpasnjëshëm nivelin e krijuar çdo vit nga Shoqata për t'i hapur rrugën burimeve të Shoqatës; dhe (ii) Banka do të konsiderojë vlefshmërinë e kredisë së Huamarrësit për huadhënie nga Banka, Shoqata mund të modifikojë, menjëherë pas rishikimit dhe miratimit të Drejtuesve Ekzekutivë të Shoqatës dhe pas marrjes në konsideratë nga ana e tyre e zhvillimit të ekonomisë së Huamarrësit, ripagimin e kësteve nën paragrafin (a) më lart duke:

(A) i kërkuar Huamarrësit të ripaguajë dyfishin e shumës së çdo kësti akoma të papaguar deri sa të ripaguhet shumata e Kredisë; dhe

(B) i kërkuar Huamarrësit të fillojë ripagimin e shumës së Kredisë përsa i përket datës së pagesës së parë gjashtë mujore së cilës i referohet paragrafi (a) më lart pas gjashtë (6) muajve ose më tepër pas datës në të cilën Shoqata njofton Huamarrësin se janë realizuar situatat e përmendura në paragrafin (b), por, megjithatë, do të lihet një periudhë minimumi prej pesë (5) vjetësh për këtë ripagim.

(c) Nëse kërkohet nga Huamarrësi, Shoqata mund të rishqyrtojë modifikimet e referuara në paragrafin (b) më lart, për të përfshirë, në vend të disa ose të gjitha rritjeve në shumat e këtyre kësteve, pagesën e interesit në një tregues vjetor për të cilin ka rënë dakord Shoqata mbi shumën e Kredisë së tërhequr herë pas here, në mënyrë që, sipas gjykimit të Shoqatës, rishqyrtimi nuk do të ndryshojë elementin e përftuar nga modifikimi i ripagesës së mësipërme.

(d) Nëse, pas modifikimit të termave në vijim të paragrafit (b) më lart, Shoqata vë re se situata ekonomike e Huamarrësit ka rënë në mënyrë të ndjeshme, Shoqata, nëse kërkohet nga Huamarrësi, mund të modifikojë më tej termat e ripagimit për të qenë në konformitet me Kreun e kësteve në paragrafin (a) më lart.

Seksioni 2.08. Valuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës specifikohet për qëllime të Seksionit 4.02 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni III Ekzekutimi i Projektit

Seksioni 3.01 (a). Huamarrësi deklaron përkushtimin ndaj objektivave të Projektit dhe se do të zbatojë Projektin nëpërmjet PMU-së me eficiencë të plotë dhe në konformitet me praktikatat e duhura

administrative, bujqësore, inxhinierike dhe ambjentaliste dhe do të sigurojë, sapo të jetë nevoja, fondet, pajisjet, shërbimet dhe të tjera burime të kërkuara për Projektin; dhe

(b) pa kufizime mbi paragrafin (a) të këtij Seksioni dhe në rast se Huamarrësi dhe Shoqata bien dakord, Huamarrësi do të ngarkojë PMU-në për zbatimin e Projektit në përputhje me Programin e Zbatimit të përcaktuar në Kreun 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02. Në rast se Shoqata do të bjerë dakord, prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve të konsulentëve që kërkohen për Projektin dhe që do të financohen nga fondet e Kredisë do të bëhet sipas vendimeve të Kreut 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.03. Për qëllime të Seksionit 9.07 të Kushteve të Përgjithshme dhe pa kufizime, Huamarrësi:

(a) do të përgatisë në bazë të udhëzimeve të pranueshme për Shoqatën dhe do t'i dërgojë Shoqatës jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas Datës së Përfundimit ose në një datë të mëvonshme siç mund të bihet dakord për këtë qëllim midis Huamarrësit dhe Shoqatës, një plan për ecurinë e Projektit në të ardhmen; dhe

(b) do t'i ofrojë Shoqatës një mundësi të arsyeshme për të shkëmbyer pikëpamje me Huamarrësin mbi planin e mësipërm.

Seksioni 3.04. Huamarrësi, deri në përfundim të Projektit, do të punësojë një drejtor të PMU-së, eksperiencë dhe kualifikimi i të cilit do të jenë të pranueshme për Shoqatën dhe do të konsultohet me Shoqatën në lidhje me zëvendësimin e drejtorit të PMU-së para zëvendësimit të tij.

Seksioni 3.05. Nëse Shoqata nuk bie dakord, Huamarrësi nuk do të ndryshojë ose alternojë Rregullat dhe Udhëzimet Operative.

Seksioni 3.06. Për qëllime të zbatimit të Pjesës A të Projektit, dhe siç do të bien dakord Huamarrësi dhe Shoqata, Huamarrësi, pa kufizime mbi obligimet e tjera të tij në këtë Marrëveshje, do të krijojë një Shoqatë Sipërmarrëse dhe do të ngarkojë PMU-në dhe Shoqatën Sipërmarrëse të zhvillojnë një propozim të hollësishëm rehabilitimi dhe vlerësim mjedisi të pranueshme për Shoqatën, në rast se Skema ndodhet pranë Trojeve Ramsar.

Neni IV

Pakti Financiar

Seksioni 4.01 (a). Huamarrësi do të ngarkojë PMU-në të mirëmbajë një sistem menaxhimi financiar, duke përfshirë arshivimet dhe llogaritë, dhe të përgatisë gjendjet financiare në përputhje me standardet e llogarisë së pranueshme për Shoqatën, që vazhdojnë të aplikohen, të përshtatshme për të reflektuar veprimet, burimet dhe shpenzimet që lidhen me Projektin.

(b) Huamarrësi do të ngarkojë PMU-në:

(i) për të pasur arshivat, llogaritë dhe gjendjet financiare të referuara në paragrafin (a) të këtij Seksioni, duke përfshirë arshivat dhe llogaritë për Llogarinë e Veçantë për çdo vit fiskal të audituar, në përputhje me standardet audituese të pranueshme për Shoqatën, që vazhdojnë të zbatohen, nga auditues të pavarur të pranueshëm për Shoqatën;

(ii) për t'i dorëzuar Shoqatës sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas çdo fund viti raportin e auditimit nga audituesit, me qëllimet dhe hollësitë që ka kërkuar Shoqata, duke përfshirë një opinion të veçantë të auditorëve përse i përket faktit nëse shpenzimet e bëra gjatë këtij viti fiskal bashkë me procedurat dhe kontrollet e brendshme të përfshira në përgatitjen e tyre, mund të besohen për të justifikuar tërheqjen e fondeve që lidhen me to;

(iii) për të informuar Shoqatën në lidhje me arshivat, llogaritë dhe auditimin siç do të kërkojë Shoqata herë pas here.

(c) Për të gjitha shpenzimet në lidhje me të cilat janë bërë tërheqje fondesh nga Llogaria e Kredisë në bazë të gjendjes së shpenzimeve, Huamarrësi:

(i) do të mirëmbajë, në përputhje me paragrafin (a) të këtij Seksioni, arshivat dhe llogaritë që reflektojnë këto shpenzime;

(ii) do të ruajë, deri të paktën një vit pasi Shoqata të ketë marrë raportin e auditimit për vitin fiskal në të cilin u bë tërheqja e fundit e fondeve nga Llogaria e Kredisë, të gjitha arshivat (kontratat, urdhrat, faturat, pagesat dhe dokumente të tjera) që pasqyrojnë këto shpenzime;

(iii) do të ndihmojë përfaqësuesit Shoqatës për të ekzaminuar këto arshiva; dhe

(iv) do të sigurojë se të tilla arshiva dhe llogari janë përfshirë në auditimin vjetor të referuar në paragrafin (b) të këtij Seksioni dhe se raporti i auditimit përmban një opinion të veçantë të audituesve përse i përket faktit nëse gjendja e shpenzimeve të bëra gjatë vitit fiskal bashkë me procedurat dhe kontrollet e brendshme të përfshira në përgatitjen e tyre, mund të besohen për të justifikuar tërheqjen e fondeve që lidhen me to.

Neni V

Dëshmipërblimet e Shoqatës

Seksioni 5.01. Në vijim të Seksionit 6.02 (1) të Kushteve të Përgjithshme specifikohen dukuritë e mëposhtme:

(a) Udhëzimet Operative do të ndryshohen, pezullohen, anulohen, hiqen ose eliminohen, në mënyrë që të ndikojnë materialisht dhe në të kundërtën, në opinionin e Shoqatës, zbatimin e Projektit; dhe

(b) Ligji nr.7846, i Huamarrësit, do të ndryshohet, pezullohet, anulohet, hiqet ose eliminohet, ose do të hyjnë në fuqi nene të tjera ligjore, në mënyrë që të ndikojnë materialisht dhe në të kundërtën, në opinionin e Shoqatës, zbatimin e Projektit.

Seksioni 5.02. Në vijim të Seksionit 7.01 (h) të Kushteve të Përgjithshme, specifikohen dukuritë e mëposhtme, dmth, se do të shfaqen dukuritë e specifikuara në Seksionin 5.01 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni VI

Data Efektive; Përfundimi

Seksioni 6.01. Dukuritë e mëposhtme janë specifikuar si kushte shtesë për efektivitetin e Marrëveshjes së Kredisë së Zhvillimit dhe ruajnë kuptimin e Seksionit 12.01 (b) të Kushteve të Përgjithshme:

(a) se një sistem manaxhimi financiar do të instalohet dhe do të jetë operativ në formë dhe përmbajtje sipas kërkesave të Shoqatës;

(b) se Udhëzimet Operative janë përgatitur dhe miratuar nga MBU në formë dhe përmbajtje sipas kërkesave të Shoqatës; dhe

(c) se janë caktuar audituesit e jashtëm sipas kërkesave të Shoqatës për qëllime të Projektit;

(d) se Ligji Draft i Ujitjes dhe Kullimit është adoptuar, siç është rënë dakord me Shoqatën; dhe

(e) se një plan veprimi për të përcaktuar borxhet e drejtorive të ujrave ndaj KESH-it është përgatitur në një mënyrë të pranueshme për Shoqatën.

Seksioni 6.02. Data nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje është specifikuar për qëllime të Seksionit 12.04 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni VII

Përfaqësuesi i Huamarrësit; Adresat

Seksioni 7.01. Ministri i Financave i Huamarrësit caktohet si përfaqësues i Huamarrësit për qëllime të seksionit 11.03 të Kushteve të Përgjithshme.

Seksioni 7.02. Adresat e mëposhtme specifikohen për qëllime të Seksionit 11.01 të Kushteve të Përgjithshme:

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Tiranë

Shqipëri

Telex: 4295 Komplan AB

Për Shoqatën:

International Development Association
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C.20433
United States of America

Cable Address:

Telex:

INDEVAS
Washington, D.C

248423 (RCA)
82987 (FTCC)
64145 (WUI) ose
197688 (TRT)

DËSHMITARËT e të dyja palëve, duke vepruar si përfaqësues të autorizuar, nënshkruan këtë Marrëveshje në emër të tyre në Shtetin e Kolumbisë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në ditën dhe vitin e shënuar më sipër.

SHQIPËRIA

Nga

Pandeli Majko
Përfaqësues i Autorizuar

SHOQATA E ZHVILLIMIT NDËRKOMBËTAR

Nga

J.D.Wolfensohn
Zëvendës President i Rajonit të
Evropës dhe Azisë Qendrore

KREU 1

Tërheqja e Fondeve të Kredisë

1. Tabela e mëposhtme përcakton Kategoritë e artikujve që financohen nga fondet e Kredisë, alokimin e shumave të Kredisë për çdo Kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për artikujt që financohen në çdo Kategori:

		Shuma e Kredisë së Alokuar (shprehur	%	e
shpenzimeve	Kategoria	në SDR)	që do tëfinancohen	
	(1) Punimet Civile nën Pjesën A të Projektit	11,860,000	90%	
	(2) Shërbimet e Konsulentëve, studimet dhe trainimet	1,770,000	100%	
	(3) Mallra	1,100,000	100% e shpenzimeve të huaja,100% e shpenzimeve lokale (kosto e dhe 85% e lokale për	
prishme) shpenzimeve artikuj të tjerë të				prokuruar në vend.

(4) Kosto operative në rritje	1,200,000	90%
(5) Të paalokuara	1,770,000	
TOTALI	17,700,000	

2. Për qëllimet e këtij Kreu:

(a) termi “shpenzime të huaja” nënkupton shpenzimet në valutën e një vendi tjetër përveç atij të Huamarrësit për mallra ose shërbime të furnizuara nga territori i një vendi tjetër përveç atij të Huamarrësit;

(b) termi “shpenzime lokale” nënkupton shpenzimet në valutën e Huamarrësit ose për mallra ose shërbime të furnizuara nga territori i Huamarrësit; dhe

(c) termi “kosto operative në rritje” nënkupton kostot e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes që nuk do të mungojnë në Projekt dhe përfshin, ndërmjet të tjerash, kostot në lidhje me: (i) mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e pajisjeve të prokuruar ose të përdorura në Projekt; (ii) pagat e stafit të PMU-së, përveç pagesave të personave të punësuar për qëllime të Projektit; dhe (iii) pajisje zyrahe më pak se 200 USD për artikull.

3. Përveç vendimeve të paragrafit 1 më lart, asnjë tërheqje fondesh nuk do të bëhet në lidhje me: (a) pagesat për shpenzime të bëra para datës së kësaj Marrëveshjeje, përveç tërheqjeve në një shumë totale që nuk i kalon 390,000 SDR që mund të bëhen në lidhje me Kategorinë (1) për llogari të pagesave të bëra për shpenzime para kësaj date, por pas 28 shkurt 1999, dhe (b) shpenzime nën Kategorinë (1) për Pjesën A të Projektit, nëse këto shpenzime nuk janë bërë në përputhje me procedurat dhe termat dhe kushtet e përcaktuara ose të referuara në Kreun 2 të Marrëveshjes së Projektit.

4. Shoqata mund të kërkojë që tërheqjet e fondeve nga Llogaria e Kredisë të bëhen në bazë të gjendjes së shpenzimeve për shpenzime nën kontratat për: (i) punime që nuk kalojnë 250,000 \$; (ii) mallra që nuk kalojnë 100,000 \$; (iii) firma konsulente që nuk kalojnë 100,000 \$ dhe për konsulentët individuale që nuk kalojnë 25,000 \$; dhe (iv) studime, trainime dhe kosto operative në rritje, nën termat dhe kushtet që Shoqata do t'i njoftojë Huamarrësit.

KREU 2 PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivat e Projektit janë: (a) të arrijë përdorimin e mjaftueshëm të ujit për ujitje për bujqësinë dhe (b) të ulë rrezikun e përmytjeve.

Projekti konsiston në pjesët e mëposhtme, që i nënshtrohen modifikimeve për të cilat Huamarrësi dhe Shoqata mund të bien dakord herë pas here për të arritur objektivat:

Pjesa A: Programi i Punimeve të Infrastrukturës

Zbatimi i skemave për, ndërmjet të tjerash: (a) rehabilitimin dhe përmirësimin e skemave të ujitjes dhe kullimit; (b) rehabilitimin e kontrollit të vërshimeve, (c) rehabilitimin e rezervuarëve të ujitjes, dhe (d) punimet e projektimit dhe të supervizionit për të mbështetur zbatimin e Pjesës A të Projektit.

Pjesa B: Mbështetja Institucionale

Vendimi i trainimit dhe këshillimit teknik shërben, ndërmjet të tjerash, (a) për të forcuar SHPU-të dhe FSHPU-të, (b) për të ndihmuar ristrukturimin e ndërmarrjeve të ujrave, dhe (c) për të mbështetur kontraktoret private.

Pjesa C: Studimet Teknike

Kryerja e studimeve në lidhje me: (a) teknologjitë e përmirësuar të ujitjes, dhe (b) përmirësimin e menaxhimit të mjedisit të lidhur me ujitjen dhe kullimin.

Pjesa D: Menaxhimi i Administrimit të Projektit

Përmirësimi i kapacitetit institucional të PMU-së, ndërmjet të tjerash, në projektimin e sistemit të informacionit, auditimin dhe vlerësimin e impaktit të veprimeve dhe identifikimi, përgatitja, vlerësimi, supervizioni dhe promovimi i skemave, nëpërmjet vendimit të asistencës teknike, trainimit dhe pajisjeve të PMU-së.

Projekti pritet të përfundojë më 30 shtator 2004

Kreu 3 PROKURIMI DHE SHËRBIMET E KONSULENCËS

Seksioni I. Prokurimi i Mallrave dhe Punimeve

Pjesa A: Të përgjithshme

1. Mallrat dhe punimet do të prokurohen në përputhje me: (a) vendimet e Seksionit I të “Udhëzimeve për Prokurime nën Kreditë IBRD dhe IDA” botuar nga Banka në janar 1995 dhe rishikuar në janar dhe gusht 1996, Shtator 1997 dhe janar 1999, nënshtruar modifikimeve të përcaktura në paragrafin 2 të Pjesës A (Udhëzimet), dhe (b) vendimet e Pjesëve të mëposhtme të Seksionit I.

2. Në paragrafet 1.6 dhe 1.8 të Udhëzimeve, referancat “vendet anëtare të Bankës” dhe “vend anëtar” do të mendohen si referanca përkatësisht të “Vendet Pjesëmarrëse” dhe “Vend Pjesëmarrës”.

Pjesa B: Procesi i Konkurrimit Ndërkombëtar

Siç është përcaktuar në Pjesën C të këtij Seksioni, mallrat dhe punimet do të prokurohen sipas kontratave të lidhura në përputhje me vendimet e Seksionit II të Udhëzimeve dhe paragrafit 5 të Shtojcës I bashkangjitur.

Pjesa C: Procedura të Tjera Prokurimi

1. Procesi i Konkurrimit Kombëtar

Punimet me kosto të vlerësuar më pak se 250,000 \$ për kontratë deri në një shumë që nuk i kalon 15.150,000 \$ mund të prokurohen nën kontratat e lidhura në përputhje me vendimet e paragrafeve 3.3 dhe 3.4 të Udhëzimeve.

2. Blerja Ndërkombëtare

Mallrat me kosto të vlerësuar më pak se 100,000 \$ për kontratë, deri në një shumë që nuk i kalon 365,000\$, mund të prokurohen nën kontratat e lidhura në bazë të procedurave të blerjeve ndërkombëtare në përputhje me vendimet e paragrafeve 3.5 dhe 3.6 të Udhëzimeve.

3. Blerja Kombëtare

Mallrat me kosto të vlerësuar më pak se 35,000 \$ për kontratë, deri në një shumë që nuk i kalon 150,000 \$, mund të prokurohen nën kontratat e lidhura në bazë të procedurave të blerjeve kombëtare në përputhje me vendimet e paragrafeve 3.5 dhe 3.6 të Udhëzimeve.

4. Kontrata e Drejtpërdrejtë

Pjesët e Këmbimit nën pronësi me kosto të vlerësuar më pak se 890,000 USD për kontratë, deri në një shumë që nuk i kalon 890,000 \$, mund të prokurohen nën kontratat e lidhura në bazë të kontratës së drejtpërdrejtë në përputhje me vendimet e paragrafit 3.7 të Udhëzimeve.

5. Prokurimi i Punimeve të Vogla

Punimet me kosto të vlerësuar më pak se 75,000 \$ për kontratë, deri në një shumë që nuk i kalon 2,200,000 USD, mund të prokurohen nën kontratat lump-sum, me çmime fikse të lidhura në bazë të ofertave të marra nga tre (3) kontraktorë vendas të kualifikuar në përgjigje të një ftese me shkrim. Ftesa do të përfshijë një përshkrim të hollësishëm të punimeve, duke përfshirë specifikimet bazë, datën e përfundimit, një formë të marrëveshjes të pranueshme nga Banka, vizatimet përkatëse, ku mund të aplikohen. Kontrata lidhet me kontraktorin që ofron çmimin më të ulët për punën e kërkuar dhe që ka eksperiencë dhe burime për të përfunduar kontratën me sukses.

Pjesa D : Rishikim nga Shoqata i Vendimeve të Prokurimit

1. Plani i Prokurimit

Para përgatitjes së ftesave për prekualifikim për konkurim ose për konkurim për kontrata, plani i propozuar i prokurimit për projektin do t'i dërgohet Shoqatës për rishikim dhe miratim, në

përputhje me vendimet e paragrafit 1 të Shtojcës 1 të udhëzimeve. Prokurimi i të gjitha mallrave dhe punimeve do të ndërmerret në përputhje me këtë plan prokurimi siç do të miratohet nga Shoqata dhe me vendimet e paragrafit 1.

2. Rishikimi Fillestar

(a) Në lidhje me secilën kontratë për mallra nën Pjesën B të këtij Kreu, punimet me vlerësim kostoje të barazvlefshme me 250,000 \$ ose më tepër dhe me kontratën e parë që do të prokurohet nën pjesën C.1 të këtij Kreu në çdo vit, do të aplikohen procedurat e përcaktuara në paragrafet 2 dhe 3 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve.

(b) Në lidhje me çdo kontratë të lidhur nën Pjesën C.4 të këtij Kreu do të aplikohen procedurat e mëposhtme:

(i) para ekzekutimit të çdo kontrate të prokuruar sipas procedurave të kontratave të drejtpërdrejta, Huamarrësi do të sigurojë për Shoqatën një kopje të specifikimeve dhe kontratës draft; dhe

(ii) do të aplikohen procedurat e përcaktuara në paragrafet 2 (f) dhe 2 (g) dhe 3 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve.

3. Rishikimi i Mëvonshëm

Në lidhje me çdo kontratë që nuk përfshihet në paragrafin 2 të kësaj Pjese, do të aplikohen procedurat e përcaktuara në paragrafin 4 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve.

Seksioni II . Punësimi i Konsulentëve

Pjesa A : Të Përgjithshme

1. Shërbimet e Konsulentëve do të prokurohen në përputhje me : (a) vendimet e parathënies dhe Seksionit IV të “Udhëzime: Seleksionimi dhe Punësimi i Konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, botuar nga Banka në janar 1997 dhe rishikuar në shtator 1997 dhe janar 1999, nënshtruar modifikimeve të përcaktuara në paragrafin 2 të kësaj Pjese A (Udhëzime për Konsulentët) dhe (b) vendimet e pjesëve vijuese të këtij Seksioni II.

2. Në paragrafin 1.10 të Udhëzimeve për Konsulentët, referencat “vendet anëtare të Bankës” dhe “vend anëtar” mendohen të jenë përkthësisht referenca të “Vendeve Pjesëmarrëse” dhe “Vend Pjesëmarrës”.

3. Seleksionimi i bazuar në cilësi dhe kosto

Siç thuhet në Pjesën B të këtij Seksioni, shërbimet e konsulentëve për komponentët e mbështetjes institucionale, studimeve teknike dhe mbështetjes së administratës së projektit do të prokurohen nën kontratat e lidhura në përputhje me vendimet e Seksionit II të Udhëzimeve për Konsulentët, paragrafi 3 i Shtojcës 1, Shtojcës 2 dhe vendimet e paragrafeve 3.13 deri në 3.18 që aplikohen për seleksionimin e konsulentëve të bazuar në cilësi dhe kosto;

Pjesa B : Procedura të tjera për seleksionimin e konsulentëve

1. Seleksionimi i bazuar në kualifikimet e konsulentëve

Shërbimet e konsulentëve për monitorimin e mjedisit me kosto të vlerësuar më pak se 15.000 \$ për kontratë dhe deri në 25,500 USD në tërësi, mund të prokurohen nën kontratat e lidhura në përputhje me vendimet e paragrafit 3.1 dhe 3.7 të Udhëzimeve për Konsulentët.

2. Seleksionimi me kosto më të ulët

Shërbimet për auditimet e llogarisë së projektit me kosto të vlerësuar më pak se 60,000 \$ në tërësi do të prokurohen nën kontratat e lidhura në përputhje me vendimet e paragrafeve 3.1 dhe 3.6 të Udhëzimeve për Konsulentët.

3. Konsulentët individualë

Shërbimet për menaxhim të përmirësuar të mjedisit, mbështetjen e peshkimit, mbështetjen e SHPU-ve dhe trainim me kosto të vlerësuar më pak se 644,550 \$ në tërësi do të prokurohen nën kontratat e lidhura me konsulentë individualë në përputhje me vendimet e paragrafeve 5.1 dhe 5.3 të Udhëzimeve për Konsulentët.

Pjesa C : Rishikim nga Shoqata i Seleksionimit të Konsulentëve

1. Plani i Seleksionimit

Para se t'i dërgohen konsulentëve kërkesat për propozime, plani i propozuar për seleksionimin e konsulentëve për projektin do t'i dërgohet Shoqatës për rishikim dhe miratim në përputhje me vendimet e paragrafit 1 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve për Konsulentët. Seleksionimi i të gjithë shërbimeve të konsulentëve do të ndërmerret në përputhje me këtë plan seleksionimi siç është miratuar

nga Shoqata dhe me vendimet e paragrafit 1.

2. Rishikimi fillestar

(a) Në lidhje me çdo kontratë për punësimin e firmave konsulente me kosto të barazvlefshme me 200,000 \$ ose më tepër, do të aplikohen procedurat e përcaktuara në paragrafet 1,2 (përveç nënparagrafit të tretë të paragrafit 2 (a)) dhe 5 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve për Konsulentët.

(b) Në lidhje me çdo kontratë për punësimin e firmave konsulente me kosto të barazvlefshme me 100,000 \$ ose më tepër, por më pak se 200,000 \$, do të aplikohen procedurat e përcaktuara në paragrafët 1, 2 (përveç nënparagrafit të dytë të paragrafit 2 (a)) dhe 5 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve për Konsulentët.

(c) Në lidhje me çdo kontratë për punësimin e konsulentëve individualë me kosto të barazvlefshme me 25,000 \$ ose më tepër, kualifikimet, eksperiencën, termat e referencës dhe termat e punësimit të konsulentëve do t'i dërgohen më parë Shoqatës për rishikim dhe miratim. Kontrata do të lidhet vetëm pasi të jetë dhënë miratimi.

3. Rishikimi i Mëvonshëm

Në lidhje me çdo kontratë që nuk bën pjesë në paragrafin 2 të kësaj pjese do të aplikohen procedurat e përcaktuara në paragrafin 4 të Shtojcës 1 të Udhëzimeve për Konsulentët.

KREU 4 PROGRAMI I ZBATIMIT

Vendimet e këtij Kreu do të zbatohen për qëllime të Seksionit 3.01 (b) të kësaj Marrëveshjeje.

Zbatimi dhe Monitorimi i Përgjithshëm i Projektit

1. Huamarrësi do të mirëmbajë PMU-në me staf të përshtatshëm, fonde, pajisje dhe burime të tjera që kërkohen për të zbatuar Projektin sipas kërkesave të Shoqatës.

2. Huamarrësi:

(a) do të mirëmbajë politikat dhe procedurat e përshtatshme që do ta ndihmojnë atë të monitorojë dhe vlerësojë në baza vazhdimësie, në përputhje me treguesit për të cilët kanë rënë dakord Huamarrësi dhe Shoqata për zbatimin e projektit dhe arritjen e objektivave;

(b) do të përgatisë, nën termat e referencës sipas kërkesave të Shoqatës dhe do t'i dërgojë Shoqatës në ose rreth 28 shkurt 2002 një raport mbi rezultatet e aktivitetit të monitorimit dhe vlerësimit, të kryera në vijim të paragrafit (a) të këtij Seksioni, mbi progresin e arritur në zbatimin e Projektit gjatë periudhës para datës së raportit dhe përcaktimin e masave të rekomanduara për të siguruar zbatimin eficient të Projektit dhe arritjet e objektivave gjatë periudhës që vijon pas kësaj date; dhe

(c) do të rishikojë me Shoqatën, rreth 30 prill 2002 ose në një datë të mëvonshme nëse do të kërkojë shoqata, raportin e referuar në nënparagrafin (b) të këtij paragrafi dhe, pastaj, do të marrë të gjitha masat që kërkohen për të siguruar përfundimin eficient të projektit dhe arritjen e objektivave, bazuar në përfundimet dhe rekomandimet e raportit dhe pikëpamjet e shoqatës mbi këtë çështje.

Pjesa A e Projektit

3. Për zbatimin e Pjesës A të Projektit, nëse Huamarrësi dhe Shoqata nuk bien dakord ndryshe, Huamarrësi do t'i zgjedhë skemat në mënyrën e mëposhtme:

(a) do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Shoqatës një studim parapërgatitor, analizat sociale dhe vlerësimin e mjedisit për çdo skemë në një skemë të re në përputhje me Udhëzimet Operative për rishikimin dhe miratimin e Shoqatës;

(b) do të ketë marrëveshje ndërmjet huamarrësit dhe çdo Përfituesi të Projektit, nën termat dhe kushtet e referuara në Udhëzimet Operative dhe që do të jenë miratuar nga Shoqata; dhe

(c) do të ushtrojë të drejtat e tij nën marrëveshje të tilla në mënyrë të tillë që të mbrojë interesat e Shoqatës dhe të përmbushë qëllimet e projektit dhe nuk do të caktojë, ndryshojë, anulojë ose heqë ndonjë nga këto marrëveshje ose vendime pa marrë më parë miratimin e Shoqatës.

Raportimi

4. Huamarrësi:

(a) do të koordinojë dhe monitorojë ekzekutimin e përgjithshëm të Projektit dhe do të

mbikqyrë zbatimin nga Përfituesit e Projektit të obligimeve të tyre në vijim të marrëveshjeve të tyre përkatëse në përputhje me politikat dhe procedurat sipas kërkesave të Shoqatës;

(b) jo më vonë se 30 nëntori i çdo viti do të përgatisë dhe dorëzojë Shoqatës për rishikim dhe komente, planet e punës dhe buxhetet për aktivitetet e çdo pjese të Projektit për vitin tjetër kalendarik, që do të përfshijë, ndërmjet shumë gjërash, propozime specifike për përdorimin e kontributit të Huamarrësit; dhe

(c) më 30 prill, 31 korrik, 31 tetor dhe 31 janar të çdo viti do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë shoqatës një raport për rishikim, me ato qëllime dhe hollësira që ka kërkuar Shoqata, mbi progresin dhe ekzekutimin e Projektit.

KREU 5 LLOGARIA E VEÇANTË

1. Për qëllime të këtij Kreu:

(a) termi “Kategori të përshtatshme” nënkupton kategoritë (1) deri në (4) të përcaktuara në tabelën në paragrafin 1 të Kreut 1 të kësaj Marrëveshjeje;

(b) termi “shpenzime të përshtatshme” nënkupton shpenzime në lidhje me koston e arsyeshme të punës, mallrave dhe shërbimeve që kërkohen për Projektin dhe që do të financohen nga fondet e Kredisë të alokuara herë pas here për kategoritë e përshtatshme në përputhje me vendimet e Kreut 1 të kësaj Marrëveshjeje; dhe

(c) termi “Alokim i Autorizuar” nënkupton një shumë baraz me 1,000,000 USD që do të tërhiqen nga Llogaria e Kredisë dhe do të depozitohen në Llogarinë e Veçantë në vijim të paragrafit 3 (a) të këtij Kreu.

2. Pagesat nga Llogaria e Veçantë do të bëhen ekskluzivisht për shpenzime të përshtatshme në përputhje me vendimet e këtij Kreu.

3. Pasi Shoqata të ketë marrë evidenca të kënaqshme se llogaria e veçantë është hapur, tërheqjet e fondeve të Alokimit të Autorizuar dhe tërheqjet e mëpasshme për të depozituar në Llogarinë e Veçantë do të bëhen si më poshtë:

(a) Për tërheqjet e Alokimit të Autorizuar, Huamarrësi do t'i bëjë Shoqatës një kërkesë ose kërkesa për një depozitim ose depozitime që nuk kalojnë shumën e Alokimit të Autorizuar. Në bazë të kësaj kërkesë ose kërkesash, shoqata në emër të huamarrësit do të tërheqë nga Llogaria e Kredisë dhe do të depozitojë në Llogarinë e Veçantë shumën ose shumat që ka kërkuar Huamarrësi.

(b) (i) Për hyrjen e parave në Llogarinë e Veçantë, Huamarrësi do t'i bëjë Shoqatës kërkesa për depozitime në Llogarinë e Veçantë në intervalet që do të përcaktojë Shoqata.

(ii) Para ose në kohën e kësaj kërkesë, Huamarrësi do t'i dorëzojë Shoqatës dokumentet dhe evidenca të tjera që kërkohen në vijim të paragrafit 4 të këtij Kreu për pagesën ose pagesat në lidhje me të cilat kërkohet hyrja e parave. Në bazë të secilës kërkesë, Shoqata, në emër të Huamarrësit, do të tërheqë nga Llogaria e Kredisë dhe do të depozitojë në Llogarinë e Veçantë shumën e kërkuar nga Huamarrësi siç është paraqitur në dokumentet në fjalë dhe evidencat e tjera se janë bërë pagesa nga Llogaria e Veçantë për shpenzime të përshtatshme.

Këto depozitime do të tërhiqen nga Shoqata nga Llogaria e Kredisë nën kategoritë përkatëse të përshtatshme dhe në shumat ekuivalente përkatëse, siç do të justifikohet nga dokumentet dhe evidencat e tjera.

4. Për çdo pagesë të bërë nga Huamarrësi nga Llogaria e Veçantë, Huamarrësi, në kohën që do të kërkojë Shoqata, do t'i dorëzojë Shoqatës dokumente dhe evidenca të tjera që tregojnë se një pagesë e tillë është bërë ekskluzivisht për shpenzime të përshtatshme.

5. Megjithë vendimet e paragrafit 3 të këtij Kreu, Shoqatës nuk do t'i kërkohet të bëjë depozitime të mëtejshme në Llogarinë e Veçantë:

(a) nëse, në çdo kohë, Shoqata do të vendosë se tërheqjet e mëtejshme të fondeve duhet të bëhen nga Huamarrësi direkt nga Llogaria e Kredisë në përputhje me vendimet e nenit V të Kushteve të Përgjithshme dhe paragrafin (a) të seksionit 2.02 të kësaj Marrëveshjeje;

(b) nëse Huamarrësi nuk do të arrijë t'i dorëzojë Shoqatës, brenda periudhës së kohës të specifikuar në Seksionin 4.01 (b)(ii) të kësaj Marrëveshjeje, ndonjë nga raportet e auditimit të kërkuar nga Shoqata në vijim të Seksionit në fjalë në lidhje me auditimin e arshivave dhe llogarive për Llogarinë e Veçantë;

(c) nëse, në çdo kohë, Banka do të njoftojë Huamarrësin për synimet e saj për të pezulluar

të tërën ose një pjesë të së drejtës së Huamarrësit për të tërhequr nga Llogaria e Kredisë në vijim të vendimeve të Seksonit 6.02 të Kushteve të Përgjithshme; ose

(d) shuma totale e patërhequr e Kredisë së alokuar për kategoritë e përshtatshme, duke zbritur shumën e ndonjë detyrimi të veçantë të papaguar të futur këtu nga shoqata në përputhje me seksionin 5.02 të kushteve të Përgjithshme në lidhje me Projektin, do të jetë e barabartë me dyfishin e shumës së Alokimit të Autorizuar.

Pas kësaj, tërheqja nga Llogaria e Kredisë e shumës së Kredisë e mbetur e patërhequr, e alokuar për kategoritë e përshtatshme do të ndjekë procedura për të cilat Shoqata do të njoftojë huamarrësin. Tërheqjet e mëtejshme do të bëhen vetëm pasi dhe deri në atë masë që do të kërkojë shoqata që të gjitha këto shuma të mbetura të depozituara në Llogarinë e Veçantë deri në datën e këtij njoftimi do të përdoren për pagesa të shpenzimeve të përshtatshme.

6.(a) Nëse Shoqata do të vendosë që një pagesë nga Llogaria e Veçantë: (i) është bërë për një shpenzim ose në një shumë jo të përshtatshme sipas paragrafit 2 të këtij Kreu; ose (ii) nuk është justifikuar me evidenca për Shoqatën, Huamarrësi, menjëherë pas njoftimit nga Shoqata: (A) do të sigurojë evidenca shtesë sipas kërkesës së Shoqatës; ose (B) do të depozitojë në Llogarinë e Veçantë (ose, nëse do të kërkojë shoqata, t'i rikthejë Shoqatës) një shumë të barabartë me shumën e pagesës ose pjesën e papërshtatshme apo të pajustificuar. Nëse Shoqata nuk bie dakord ndryshe, nuk do të bëhet asnjë depozitim i mëtejshëm nga Shoqata në Llogarinë e Veçantë derisa Huamarrësi të ketë siguruar evidencat ose të ketë bërë depozitimin, sipas rastit.

(b) Nëse Shoqata do të vendosë që ndonjë shumë e pashpenzuar në Llogarinë e Veçantë nuk do të kërkohej për të mbuluar pagesa të mëtejshme për shpenzime të përshtatshme, huamarrësi, menjëherë pas njoftimit të Shoqatës, do t'i kthejë Shoqatës këtë shumë.

(c) Huamarrësi, pas njoftimit nga Shoqata, mund t'i kthejë Shoqatës të gjithë ose një pjesë të fondeve të depozituara në Llogarinë e Veçantë.

(d) Kthimi i fondeve Shoqatës bërë sipas paragrafit 6 (a), (b) dhe (c) të këtij Kreu do t'i kreditohet Llogarisë së Kredisë për tërheqje të njëpasnjëshme ose për anulim në përputhje me vendimet përkatëse të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë Kushtet e Përgjithshme.